



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
Senati akademik

Nr. 4191 prot.

Shkodër, më 22.12.2023

Vendim

Nr. 287 datë 22.12.2023

"Për caktimin e anëtarit të Bordit të Administrimit në mandatin plotësues për një përfaqësues të USH-së"

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, dt. 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 38, pika 1, shkronja "gj", Neni 50, pika 4; Statutin e USH-së, Neni 17, pika 6, germa "l" dhe neni 28, pika 11; Regulloren e Bordit të Administrimit, neni 6, pika 2; dorëheqjen e pedagoges Brunilda Lufi si pedagoge e brendëshme e USH-së që shënon mbarimin e parakohshëm të mandatit të saj në Bordin e Administrimit, si dhe në relacionin e mbledhjes së datës 4. 10. 2021 të Senatit Akademik për renditjen zbritëse në zgjedhjet për Bordin e Administrimit më 4.10.2021, pasi shqyrtoi nevojën e plotësimit të menjëhershëm të vendit të lirë në Bordin e Administrimit, në mbledhjen e datës 22.12.2023

Vendosi:

1. Të plotësojë vendin e lirë në Bordin e Administrimit të krijuar nga mbarimi i parakohshëm i mandatit të një anëtari përfaqësues të USH-së me pedagogen Prof. As. Dr. Entela Hoxhaj Baci.
2. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORE

Prof. dr. Rajmondë Këcira

